

**UDHËZUES PËR SKEMËN E GRANTEVE TË INOVACIONIT NË TEKNOLOGJINË E
INFORMACIONIT DHE TË KOMUNIKIMIT (TIK) - KATEGORIA EKONOMIKE SUBVENCIONE
DHE TRANSFERE**

PËR

NMVM DHE BIZNESET START-UP

Skema e Granteve

(Loti 1 dhe Loti 2)

Autoriteti kontraktues:

**MINISTRIA E INDUSTRIJË, NDËRMARRËSISË, TREGTISË DHE INOVACIONIT (MINTI)
AGJENCIA E LUKSEMBURGUT PËR BASHKËPUNIM ZHVILLIMOR (LUXDEV)**

Autoriteti implementues:

Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit dhe dokumenteve përcjellëse:

Nga 03.07.2026 deri më 23.07.2026 në orën 24:00

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE	3
2.	QËLLIMI	3
3.	OBJEKTIVAT E THIRRJES PUBLIKE	3
4.	MBËSHTETJE FINANCIARE E OFRUAR NGA AUTORITETI KONTRAKTUES	3
5.	RREGULLAT E THIRRJES PUBLIKE	4
5.1.	Kualifikimi i aplikuesve: Kush mund të aplikojë?	4
5.2.	Kriteret e kërkuara.....	4
5.3.	Sqarime shtesë:.....	7
5.4.	Aplikantët që nuk kualifikohen.....	8
6.	FUSHAT E MBËSHTETJES	8
7.	SHPENZIME TË PRANUESHME	9
8.	PRANUESHMËRIA E SHPENZIMEVE	10
9.	KOHËZGJATJA	11
10.	KUSHTET E PAGESËS	12
11.	SI TË APLIKONI DHE PROCEDURAT QË DUHET TË NDIQEN PËR TË DYJA LOTET	12
12.	AFATI I FUNDIT PËR APLIKIM	12
13.	INFORMACIONE TË MËTEJSHME NË LIDHJE ME APLIKIMIN	12
14.	KRITERET E VLERËSIMIT	12
15.	ANKESAT	13
16.	LISTA E SHTOJCËVE	14

1. HYRJE

SKEMA E GRANTEVE PËR INOVACION NË TEKNOLOGJINË E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT për "NMVM dhe bizneset Start-Up-ët"

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI) në bashkëpunim me Agjencinë e Luksemburgut për Bashkëpunim dhe Zhvillim (LuxDev), përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) dhe Projektit KSV/023 – "Rritje e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse", shpall skemën e granteve për inovacion në TIK me qëllim mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme - NMVM, të themeluara deri më 31.12.2020 (përfshirë) dhe bizneseve Start-Up, të themeluara ndërmjet datave 01.01.2021 dhe 31.12.2025 (përfshirë).

"Inovacion" - do të thotë një produkt, shërbim ose proces i ri ose i përmirësuar (ose kombinim i tyre) i cili ndryshon dukshëm nga produktet, shërbimet ose proceset e mëparshme dhe vihet në dispozicion të shfrytëzuesve potencial.

2. QËLLIMI

Skema e Granteve ka për qëllim financimin e **Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme - NMVM dhe bizneseve Start-Up**, projektet e të cilave synojnë të zhvillojnë ide inovative për produkte, shërbime dhe procese të reja ose të përmirësuara (ose kombinime të tyre) në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK).

3. OBJEKTIVAT E THIRRJES PUBLIKE

Qëllimi kryesor i kësaj skeme grantesh është të inkurajojë ide dhe projekte inovative, të cilat do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Përmes kësaj skeme grantesh, MINTI synon të krijojë vende të reja pune dhe të rrisë eksportet duke forcuar kapacitetet inovative dhe duke zhvilluar produkte dhe shërbime të reja ose të përmirësuara të TIK-ut, në aspektin e metodave, cilësisë ose formës së një shërbimi, produkti ose procesi.

Sektorët e pranueshëm për të aplikuar sipas kodeve NACE, ku fushë veprimtaria primare ose sekondare duhet të jetë në njërin nga kodet si në vijim: Kodi 61 Telekomunikimi, Kodi 62 Programimi kompjuterik, konsulenca dhe aktivitetet e ndërlidhura dhe Kodi 63 Infrastruktura kompjuterike, përpunimi i të dhënave, hostimi dhe aktivitete të tjera të shërbimeve të informacionit.

4. MBËSHTETJE FINANCIARE E OFRUAR NGA AUTORITETI KONTRAKTUES

Shuma totale e kësaj thirrjeje është 1,160,000 Euro nga kategoria buxhetore ekonomike e subvencioneve dhe transfereve të MINTI (600,000 Euro) dhe nga LuxDev (560,000 Euro).

Ndarja buxhetore sipas loteve është si në vijim:

- 760,000 euro për NMVM-të -Lotin 1 dhe
- 400,000 euro për Start-Up-ët- Lotin 2

	Loti 1: NMVM-të	Loti 2: Start-Up-ët
--	-----------------	---------------------

Vlera maksimale e grantit	Maksimum deri në 50% të projektit inovativ të TIK-ut Vlera minimale e grantit është 30,000 euro dhe vlera maksimale është 50,000 euro.	Maksimum deri në 80% të projektit inovativ të TIK-ut Vlera minimale e grantit është 15,000 euro dhe vlera maksimale është 25,000 euro.
Pjesëmarrja/ bashkëfinancimi i aplikuesit	Minimumi 50% e projektit inovativ pa shumë maksimale	Minimumi 20% e projektit inovativ pa shumë maksimale

Shënim: Autoriteti Kontraktor (MINTI/KIESA dhe LuxDev) rezervon të drejtën për të mos shpërndarë të gjitha fondet e disponueshme.

Sqarim për Lotin 1 dhe Lotin 2:

- Aplikuesi mund të ushtrojë të drejtën për ta dorëzuar projekt propozimin për implementim me një vlerë më të ulët se vlera maksimale e paraqitur në këtë thirrje publike (por jo më të ulët se vlera minimale). Megjithatë, përqindja e pjesëmarrjes do të jetë e njëjtë sipas përshkrimeve të specifikuara më sipër: për NMVM-të me 50% dhe për bizneset Start-Up me 20%.
- Aplikuesi mund të dorëzojë një projekt-propozim me vlerë më të lartë se maksimumi i paraparë në këtë thirrje. Në këtë rast, përqindja e bashkëfinancimit të aplikuesit do të ndryshojë, ndërsa autoritetet financuese do të mbulojnë jo më shumë se shumën maksimale: deri në 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro) për një përfitues në Lotin 1 - NMVM-të, dhe deri në 25,000 € (njëzet e pesë mijë euro) për Lotin 2 Start-Up.

5. RREGULLAT E THIRRJES PUBLIKE

5.1. Kualifikimi i aplikuesve: Kush mund të aplikojë?

- Aplikuesit duhet të jenë Ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme - NMVM, të themeluara deri më 31.12.2020 (përfshirë) dhe bizneseve Start-Up, të themeluara ndërmjet datave 01.01.2021 dhe 31.12.2025 (përfshirë), aktiviteti primar ose sekondar i të cilave bie brenda sektorit të TIK-ut (kodet NACE 61, 62 ose 63).

5.2. Kriteret e kërkuara

Kriteret e kërkuara sipas Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr. 01/2018 për Shpërndarjen e Mjeteve Financiare nga Kategoritë Ekonomike të Subvencioneve dhe Transfereve

Dhe

Kritere të tjera të nevojshme

	Kriteret	Dokumentet për t'u dorëzuar
1	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NMVM) ¹ : duhet të jenë të regjistruara si biznes në Kosovë jo më vonë se 31.12.2020 (përfshirë). Start-UP-ët duhet të jenë të regjistruar si biznes në Kosovë midis 01.01.2021 dhe 31.12.2025 (përfshirë).	Një Certifikatë e plotë e Regjistrimit të Biznesit, duke përfshirë të gjitha faqet me informacionin mbi biznesin (me informacion mbi ID-në unike, emrin e biznesit, kapitalin, aktivitetin dhe kodet e aktivitetit, pronarët e regjistruar).

^{t1} Këtu përfshihen edhe mikrondërmarrjet

2	Duhet të ketë një numër fiskal të vlefshëm në Kosovë.	Certifikatë Numri Fiskal (nuk zbatohet për bizneset që kanë Numrin e Regjistrimit të Biznesit dhe Numrin Fiskal në një certifikatë).
3	Vërtetim tatimor me të cilën vërtetohet se Aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore, ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK.	Vërtetim tatimor i lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), jo më i vjetër se 90 ditë.
4	Lista e punëtorëve	Lista e punëtorëve e lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) mund të shkarkohet nga faqja e internetit e ATK-së, si më poshtë: • NMVM/Bizneset Start-Up: Lista e punëtorëve e lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) për vitin 2025 dhe për vitin 2026 nga janari deri në maj 2026. • Start-Up-ët e regjistruara në çdo kohë gjatë vitit 2025: dorëzoni listën e punëtorëve të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) nga muaji i regjistrimit deri në fund të vitit 2025, dhe për vitin 2026, nga janari deri në maj 2026.
5	Identifikimi i aplikantit	Një kopje e vlefshme e kartës së identitetit të personit në emrin e të cilit është regjistruar ndërmarrja.
6	Nuk duhet të jetë në falimentim, as nën administrim gjyqësor.	Dokumenti origjinal i lëshuar nga Gjykata Themelore - kërkohet origjinali jo më i vjetër se 30 ditë. Dokumenti mund të nxirret në Gjykatën Komerciale të Kosovës
7	Duhet të ketë një llogari bankare aktive në njërën nga bankat e licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës.	Dëshmi e xhirollogarisë aktive në emër të biznesit aplikues e lëshuar nga njëra nga bankat e licensuara nga Banka Qendrore e Kosovës, origjinale dhe e vulosur. Dëshmia duhet të jetë brenda afatit të hapjes së thirrjes
8	Duhet të ketë qarkullim bankar në emër të biznesit aplikues për vitin e fundit (2025).	Gjendja e xhirollogarisë bankare në emër të kompanisë aplikuese. • Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe Start-Up-ët: qarkullimi për të gjithë vitin 2025

		dhe qarkullimi për periudhën janar-maj 2026. Start-Up-ët e regjistruara në çdo kohë gjatë vitit 2025: qarkullimi nga data e regjistrimit deri në fund të vitit 2025, dhe qarkullimi për periudhën janar-maj 2026
9	Të mos ketë pranuar mjete nga burimet tjera të financimit për të njejtat aktivitet;	E dëshmuar me deklaratën nën betim për pranim të mjeteve (Shtojca 3).
10	Të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burime publike të financimit nga MINTI për dy vitet e fundit.	E dëshmuar me deklaratën nën betim për detyrime (Shtojca 4).
11	Duhet të ketë qarkullim për vitin fiskal të mëparshëm nga ATK (2024 dhe 2025).	Pasqyra e përgjithshme e deklaratave dhe transaksioneve të tjera të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) të cila dëshmojnë qarkullimin si në vijim: për bizneset aktive gjatë viteve 2024 dhe 2025, qarkullimin për vitin 2024 dhe 2025, si dhe për periudhën janar–maj 2026; ndërsa për Start-Up-ët e regjistruara gjatë vitit 2025, qarkullimin nga data e regjistrimit deri në fund të vitit 2025 dhe për periudhën janar–maj 2026
12	Dorëzoni një projekt propozim sipas formës/shabllonit të dhënë	Projekt propozimi/aplikacioni duhet të përfshijë: qëllimin, aktivitetet e projektit, kostot financiare dhe afati kohor për zbatimin e projektit, si dhe struktura organizative e Aplikuesit. Duhet të dorëzoni formularin e aplikimit, të hartuar nga autoriteti kontraktues, i publikuar më këtë thirrje dhe në e-Kosova. * Nëse ngarkoni ndonjë formular tjetër përveç formularit të lartëcekur, aplikimi juaj diskualifikohet.
13	Provë për “pitch”	Një video me kohëzgjatje deri në 2 minuta që paraqet konceptin e propozimit të projektit duhet të ndahet përmes e-Kosova përmes një linku, vetëm në njërën nga platformat e mëposhtme: YouTube,

		Google Drive, Vimeo, One Drive ose Dropbox.
--	--	---

Shënim i rëndësishëm:

Në mungesë të cilitdo prej dokumenteve të kërkuara më sipër, aplikim do të konsiderohet i paplotë. Subjektet aplikuese do të përjashtohen nga procedura dhe nuk do të merren në shqyrtim për vlerësim.

5.3. Sqarime shtesë:

- Aplikacionet mund të plotësohen në cilëndo gjuhë prej këtyre, shqipe, serbe ose angleze.
- Një aplikues nuk mund të paraqesë më shumë se një aplikacion për këtë thirrje.
- Çdo propozim projekti që nuk është në përputhje me këtë thirrje publike nuk do të pranohet.
- Aplikantët nuk mund të ndryshojnë veprimtaritë parësore apo dytësore të biznesit pas hapjes së kësaj thirrje publike.
- Aplikuesi duhet ta paraqesë pjesëmarrjen e financimit të tij në pjesën e buxhetit të aplikacionit.
- Në rastet kur ka mospërputhje të vlerave buxhetore në projekt, konfuzion në përshkrimin e projektit, ose gabime në formularët e përcaktuar në këtë Skemë të Granteve, projekti do të diskualifikohet.
- Në rast se aplikuesi shpallet përfitues i grantit, do të nënshkruhet një marrëveshje trepalëshe (midis përfituesit, MINTI/KIESA dhe LuxDev).
- Kohëzgjatja e zbatimit të projektit të financuar nga MINTI nuk mund të kalojë 12 muaj, përfshirë raportimin.
- Për aplikuesit në të dy Lotet (NMVM-të në Lotin 1 dhe Startup-et në Lotin 2), para nënshkrimit të marrëveshjes, janë të detyruara të ofrojnë një garanci të vlefshme të lëshuar nga një Institucion Financiar i Regjistruar (RFI) i licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), që mbulon vlerën totale të kështit të parë (avans pagesës) dhe është e vlefshme për kohëzgjatjen e projektit (12 muaj) plus katër muaj të tjerë.
- Përfituesit duhet të dorëzojnë raportin narrativ dhe financiar të paktën dy javë para skadimit të marrëveshjes.
- Pajisjet që kërkojnë të subvencionohen duhet të jenë të reja (ky artikull do të jetë pjesë e marrëveshjes trepalëshe të grantit).
- Përfituesi, i cili ka nënshkruar një kontratë me MINTI/KIESA dhe LuxDev, nuk ka të drejtë të shesë asnjë pajisje të blerë nga ky grant brenda 3 (tre) viteve nga data e nënshkrimit të kontratës. Kjo klauzolë do të jetë pjesë integrale e marrëveshjes trepalëshe të grantit.
- Në rast të ndonjë kostoje të paparashikuar në lidhje me implementimin e projektit që nuk është parapa në projekt propozimi, përfituesi do të jetë përgjegjës për mbulimin e këtyre kostove.
- Në rast të përfitimit nga granti, nuk lejohet ndryshim i idesë kryesore siç përshkruhet në propozimin e projektit gjatë fazës së zbatimit të projektit.
- Bizneset që kanë përfituar nga burimet publike të financimit nga MINTI/KIESA, gjatë viteve 2024, 2025 dhe 2026, nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga kjo thirrje, përveq bizneseve që kanë përfituar nga Skema për shërbime të Digjitalizimit dhe Skema e Certifikimit.
- Deklarata nën betim do të jetë pjesë integrale e aplikimit dhe kontratës.

- Përfituesit do të jenë ato biznese që renditen me pikët më të larta nga komisioni i vlerësimit, varësisht nga limitet e planifikuara të buxhetit.
- Vetëm lista e bizneseve përfituese do të publikohet në faqet përkatëse të internetit.

5.4. Aplikantët që nuk kualifikohen

Subjektet afariste që kanë falimentuar ose janë në proces mbylljeje, janë nën administrim gjyqësor, kanë pezulluar aktivitetet afariste ose u janë nënshtruar procedurave që lidhen me këto çështje, nuk mund të marrin pjesë në thirrje ose të jenë përfitues të skemës së granteve, si dhe ato që nuk i plotësojnë kriteret e mësipërme.

6. FUSHAT E MBËSHTETJES

Nëpërmjet kësaj skeme të granteve për inovacion në TIK, *Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit* synon të mbështesë sektorin e TIK-ut që ndikon në zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik, bazuar në objektivat e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit dhe strategjive të tjera sektoriale që adresojnë objektivat në fushën e inovacionit.

	Loti 1: NMVM dhe Loti 2: Start-Up	
Sektorët	Sektori i TIK-ut që synon inovacion në produkte, shërbime apo procese të reja ose të përmirësuara, apo kombinim i tyre, që kontribuojnë në ekonominë qarkore dhe/ose në tranzicionin e dyfishtë, përkatësisht tranzicionin e gjelbër dhe tranzicionin digjita.	
Përmbajtja e projektit	Një Inovacion biznesi në TIK (Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit) është krijimi dhe zbatimi i ideve, teknologjive ose qasjeve të reja në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit që i sjellin vlerë të shtuar organizatës. Përkufizimi kryesor Inovacioni në TIK përfshin përmirësimin e një procesi, produkti, shërbimi ose zgjidhjeje komunikimi ekzistuese duke përdorur teknologjinë dhe duke siguruar adoptimin e saj nga përdoruesit (klientët ose punonjësit).	
Inovacioni mund të përfshijë:	Lloji	Shembuj konkretë
	Produkte të reja /mjete të reja	Softuer me një veçori të paparë, një aplikacion inovativ për celularë, pajisje inteligjente,
	Procese transformuese	Automatizimi i detyrave të përsëritura nëpërmjet inteligjencës artificiale, dixhitalizimi i rrjedhave të punës, zgjidhje për qeverisjen elektronike, sisteme të

		menaxhimit të biznesit inteligjent
	Teknologjitë në zhvillim	Inteligjenca artificiale, cloud computing, IoT (Interneti i Gjërave), blockchain, zgjidhje për sigurinë kibernetike, analiza e të dhënave të mëdha/big data
	Zgjidhje bashkëpunuese	Mjete pune në distancë, platforma e-learning, hapësira pune virtuale, sisteme bashkëpunimi online, zgjidhje telekonferencash

7. SHPENZIME TË PRANUESHME

Sipas kësaj thirrjeje publike për financimin e propozimeve të projekteve, objekti i të cilave janë investimet në teknologjitë dixhitale, do të mbështeten aktivitetet e mëposhtme të kualifikuara.

Shënim: Është detyrë e kompanisë aplikuese të përcaktojë se cilat lloje të kostove të listuara më poshtë janë të nevojshme për zhvillimin e projektit të tyre. Kjo **nuk** nënkupton që një projekt propozim duhet të përfshijë të gjitha llojet e kostove të listuara, mirëpo duhet të përfshijnë të paktën 2 nga 4 kategoritë e listuara në tabelën e më poshtme dhe duhet të përfshijë patjetër një të një nga kategoritë e kostove 7.1 Investimet në hulumtim dhe zhvillim (R& D) ose 7.2 Investimet në asete në formën e Harduer-it në propozimin e projektit.

Loti 1 dhe Loti 2:

Lloji i kostos	Përshkrimi	Shumat e lejuara (të vlerës totale të projektit)
7.1. Investimet në hulumtim dhe zhvillim (R& D)* Investimet në hulumtim dhe zhvillim (R&D) përfshijnë kostot që lidhen me aktivitetet hulumtuese/kërkimore teknike në fushën e ICT-së për zhvillimin e zgjidhjeve inovative,	Angazhimi i ekspertizës profesionale dhe shërbimeve që lidhen me hulumtim dhe zhvillimin e projektit në TIK, duke përfshirë blerje të licenca të softuerit, abonime, dhe certifikime që janë në	

si dhe dizajnin, zhvillimin, testimin dhe validimin e tyre, duke përfshirë prototipimin, zhvillimin e softuerit, integrimin e sistemeve, optimizimin e performancës dhe <i>hulumtimin e tregut</i> si aktivitet mbështetës për vlerësimin e potencialit të tyre në treg. *Kostot e <i>hulumtimit të tregut</i> , si pjesë e linjës buxhetore "Investime në hulumtim dhe Zhvillim", nuk mund të kalojnë më shumë se 5% të vlerës së projektit.	funksion të zhvillimit të projektit.	
7.2. Investimet në asete në formën e Harduer-it:	Investime në infrastrukturën e TIK-ut, pajisje dhe komponentë elektronikë që mbështesin zbatimin e projektit të TIK-ut.	
7.3. Pagat e punëtorëve** ** Keni parasysh se angazhimi i punëtorëve ekzistues në zhvillimin e projektit nuk konsiderohet shpenzim i pranueshëm, pasi vetëm punëtorët e rinj konsiderohen shpenzim i pranueshëm.	Pagat për punëtorët e rinj të nevojshëm për të zbatuar propozimin e projektit.	Jo më shumë se 20% e shumës totale të projektit .
7.4. Investime në promovimin e një produkti, shërbimi ose procesi inovativ ose kombinimit të tyre.	Investime në promovimin e produkteve, shërbimeve ose proceseve inovative të reja ose të përmirësuara.	Jo më shumë se 20% e shumës totale të projektit.

8. PRANUESHMËRIA E SHPENZIMEVE

- Shpenzim i pranueshëm është vetëm kostoja e shpenzimeve të realizuara, të vërtetuara me fatura të rregullta dhe transaksione bankare, duke përfshirë pagesat përmes kartave bankare.
- Të gjitha shpenzimet duhet të jenë në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë thirrje. Vetëm "shpenzimet e pranueshme" mund të merren parasysh për shumën totale të projektit. Kostot e pranueshme duhet të bazohen në kostot aktuale të parashikuara në propozimin e projektit dhe dokumentet mbështetëse.
- Në rast të ndonjë përpjekje mashtrimi (p.sh. falsifikimi i faturave, tentativa e qëllimshme për keqpërdorim të fondeve), Autoriteti Kontraktues e rezervon të drejtën ta ndalojë kështu pagesën dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore përkatëse kundër biznesit përfitues të përfshirë në mashtrim. Është në interesin e aplikuesit ta dorëzojë një buxhet real dhe me kosto efektive.

- Nuk pranohen projekte apo zhvillime që janë realizuar para nënshkrimit të kontratës. Do të kërkohen dëshmi që vërtetojnë se zhvillimi i një produkti apo shërbimi të ri, ose modifikimi i një produkti apo shërbimi ekzistues, ka ndodhur brenda afatit të Marrëveshjes së Bashkëfinancimit.
- Për linjën buxhetore "Investimet në Hulumtim dhe Zhvillim (R&D)", përfituesit e kësaj Skeme të Granteve nuk lejohen të kontraktojnë ose të pranojnë shërbime R&D nga një përfitues tjetër i së njëjtës skemë. Çdo shpenzim i tillë do të konsiderohet i papranueshëm dhe nuk do të financohet nga granti.
- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) është një shpenzim i pranueshëm sipas kësaj Skeme Granti vetëm për kompanitë që nuk deklarojnë TVSH-në. Për kompanitë që janë deklaruese të TVSH-së, ky shpenzim nuk është i pranueshëm.
- Shpenzimet e kryera para nënshkrimit të marrëveshjes së grantit nuk janë të pranueshme për financim. Buxheti përfundimtar i miratuar do t'i nënshtrohet verifikimit nga Autoriteti Kontraktues.

Shpenzime shtesë të papranueshme:

- Blerja e telefonave nuk është shpenzim i pranueshëm
- Pajisje standarde (PC, laptopë, aksesore, etj.) që nuk lidhen drejtpërdrejt me Projektin e TIK-ut;
- Softuer standard (p.sh. aplikacione zyre ose sisteme operative) që nuk lidhen drejtpërdrejt me projektin e TIK-ut;
- Zëvendësim ose investime rutinë, p.sh., kompjuterë shtesë për punonjësit e rinj ose përmirësime të softuerëve;
- Konsulencë e përgjithshme biznesi;
- Pjesëmarrja në panairë ose konferenca tregtare ose teknologjike;
- Shërbimet e ofruara nga kompanitë e lidhura me kompaninë aplikuese (p.sh. brenda një grupi ose degëve);
- Kostot që lidhen me përgatitjen e aplikimit
- Kosto për pagesa të qiramarrjes, etj.

Rishpërndarja e kostove midis linjave të miratuara të buxhetit lejohet deri në 10% pa miratim paraprak nga Autoriteti Kontraktues, me kusht që rialokimi të mos kalojë kufirin maksimal të linjave përkatëse të buxhetit.

Gjatë fazës së monitorimit, nëse shuma totale e shpenzimeve të pranueshme është më e ulët se shuma totale e projektit të miratuar në aplikim, shuma fillestare e grantit do të zvogëlohet në mënyrë proporcionale.

9. KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e projektit të financuar nga MINTI/KIESA dhe LuxDev nuk mund të kalojë **12** muaj.

10. KUSHTET E PAGESËS

Grante	Loti 1: NMVM dhe Loti 2: Start-Up
Pagesa avans	80% e grantit pas nënshkrimit të marrëveshjes trepalëshe
Kushti për dhënie të avansit	Garancioni në vlerë prej 80% të vlerës së grantit (që korrespondon me 100% të vlerës së kështit të parë / avans-pagesës)
Kësti i fundit	20% e grantit pas përfundimit të projektit dhe miratimit nga autoriteti kontraktues.

11. SI TË APLIKONI DHE PROCEDURAT QË DUHET TË NDIQEN PËR TË DYJA LOTET

- Aplikimi bëhet vetëm përmes platformës e-Kosova
- Njoftimi i thirrjes publike është publikuar në faqen e internetit të MINTI dhe KIESA:

⇒ <https://mint.rks-gov.net>

⇒ <http://kiesa.rks-gov.net>

12. AFATI I FUNDIT PËR APLIKIM

Afati i fundit për aplikime është deri më 23.07.2026 , ora 24:00 dhe aplikimet pas kësaj ore nuk pranohen.

13. INFORMACIONE TË MËTEJSHME NË LIDHJE ME APLIKIMIN

Informacione dhe sqarime shtesë mund të merren përmes email-it në adresën: sme.kiesa@rks-gov.net në përputhje me UA/01/2018/MIN, por jo më vonë se pesë (5) ditë pune para mbylljes së thirrjes publike.

14. KRITERET E VLERËSIMIT

Kriteret e përzgjedhjes nga komisioni i vlerësimit:

1. Vlerësimi administrativ:

- Për t'u përzgjedhur administrativisht, aplikuesi duhet të paraqesë të gjitha dokumentet e kërkuara. Vetëm aplikimet që janë në përputhje me kërkesat administrative do të përcillen për vlerësim teknik.

2. Vlerësimi teknik:

- Për të përmbushur teknikisht kriteret e vlerësimit, aplikimet duhet të marrin të paktën 50 nga 100 pikë në total.
- Aplikacionet që marrin minimumi 50 pikë do të renditen sipas pikëve të fituara (aplikacioni me numrin më të lartë të pikëve do të renditet i pari)

- MIET/KIESA dhe LuxDev do të japin grante bazuar në disponueshmërinë e buxheteve për Lotin 1 (760,000 Euro) dhe Lotin 2 (400,000 Euro) .

Kriteret për vlerësimin teknik janë si më poshtë:

<i>Kriteret për vlerësim</i>	<i>Pikë</i>
<i>Inovacioni/Relevanca:</i>	<i>30</i>
• Koncepti/zgjidhja inovative duke përfshirë krijimin e produktit/shërbimit të ri dhe Video Prezantimin-Pitch	<i>10</i>
• Avantazhi unik konkurrues i produktit/Pozicionim në treg	<i>5</i>
• Modeli i të ardhurave	<i>5</i>
• Potenciali për zgjerim, rritje dhe qëndrueshmëria	<i>5</i>
• Përqindja e rritjes së qarkullimit gjatë dy viteve të fundit	<i>5</i>
<i>Fizibiliteti</i>	<i>30</i>
• Cilësia e ekipit dhe partneritetet	<i>10</i>
• Buxheti: qartësia dhe arsyeshmëria e përdorimit të fondeve, si dhe koherenca me aktivitetet	<i>15</i>
• Koherenca e planit të veprimit	<i>5</i>
<i>Ndikimi</i>	<i>20</i>
• Qartësia e objektivave të projektit	<i>5</i>
• Potencial për zhvillim, duke përfshirë eksportet dhe krijimin e vendeve të reja të punës	<i>10</i>
• Kapaciteti për të përfituar fonde/shtesë shtesë	<i>5</i>
<i>Ndërdisciplinore</i>	<i>20</i>
• Pajtueshmëria me ekonominë qarkore, tranzicionin e gjelbër dhe dixhital ose kombinimin e tyre	<i>12</i>
• Kontributi në punësimin e grave dhe të rinjve	<i>8</i>

15. ANKESAT

Pas publikimit të rezultateve, aplikantët që nuk janë shpallur përfitues të kësaj skeme grantesh mund të paraqesin ankesat e tyre në aplikacionin e-Kosova.rks-gov.net, brenda 8 ditëve pune nga data e publikimit të rezultateve paraprake.

Shënim i rëndësishëm:

- Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim brenda 8 ditëve pune dhe të përfshijnë të gjithë dokumentacionin përkatës që mbështet kërkesën.
- Komiteti i Ankesave do të shqyrtojë të gjitha ankesat në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MTI 01/2018).

16. LISTA E SHTOJCËVE

Aplikantët ftohen të plotësojnë formularin e aplikimit të hartuar nga autoriteti kontraktues të publikuar me këtë thirrje si shtojca 1 dhe në e-Kosova. Vetëm ky formularë i aplikimit është i pranueshem.

- Shtojca 1 Formulari i aplikimit duke përfshirë përshkrimin e projektit, afatin kohor/planin e punës dhe buxhetin.
- Shtojca 2 Udhëzues i shkurtër se si të bëni një prezantim video.
- Shtojca 3 Deklarata nën betim për pranim të mjeteve e plotësuar dhe e nënshkruar.
- Shtojca 4 Deklarata nën betim për detyrime e plotësuar dhe e nënshkruar.